



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA

**ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT
NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE
NATIONAL AUDIT OFFICE**

Nr. i Dokumentit: 23.7b.1-2016-08

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR RAPORTIN FINANCIAR VJETOR TË
NDËRMARRJES PUBLIKE HEKURUDHAT E KOSOVËS -
TRAINKOS -SH.A**

PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2016

Prishtinë, Maj 2017

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhimin e shëndoshë financiar në administratën publike. Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Ndërmarrjes Publike *Hekurudhat e Kosovës - Trainkos sh.a*, në konsultim me U.D. Ndihmës Auditoren e Përgjithshme *Vlora Mehmeti*, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nga, *Ganimete Dalloshi (Udhëheqëse Ekipi) dhe Valmira Jonuzi* nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, *Enver Boqolli*.

TABELA E PËRMBAJTJES


Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	6
2 Qeverisja.....	11
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	15
Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit	31
Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA.....	32
Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	35

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Raportit Financiar Vjetor të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A. (më tutje Trainkos) për vitin 2016, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2016 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare vjetore. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit¹, të datës 28/10/2016.

Auditimi ynë është fokusuar në (është dhënë në hollësi në Shtojcën 1):



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2016 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Trainkos-it.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kundërt

Pasqyrat Financiare Vjetore, nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Trainkos për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër.

Për më gjerësisht shih Pjesën 1.2 të këtij Raporti.

Shtojca II, shpjegon llojet e ndryshme të opinioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Dëshirojmë të falënderojmë Kryesuesin e Bordit dhe stafin e tij për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

¹ Termi "Plani i Jashtëm i Auditimit" është zëvendësim i termit "Memorandumi i Planifikimi të Auditimit"

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Kryesuesit të Bordit – auditimi 2016**

Kryesuesi i Bordit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do ti adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

1.1 Hyrje

Rishikimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV-ve) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshin një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë aksionarit dhe publikut të gjerë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

1.2 Opinioni i auditimit

Opinion i kundërt

Ne kemi audituar pasqyrat vjetore financiare të Trainkos-it për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, të cilat përfshijnë të cilat përfshijnë pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese.

Sipas opinionit tonë, për shkak të efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin për Bazën për Opinion të Kundërt, pasqyrat vjetore financiare nuk paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë, në të gjitha aspektet materiale, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akrual të kontabilitetit, Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Baza për opinion të kundërt

Ne kemi krijuar bazën për opinionin të kundërt, për arsyet e përmendura në vijim:

- Sipas SNK-ve, llogaria pezull është një llogari e përkohshme dhe në asnjë rrethanë nuk duhet të ketë ende llogari pezull në kohën kur përgatitet pasqyra e pozicionit financiar. Në shënimet kontabël, në anën kreditore ekziston shuma prej 340,000€ me përshkrimin "pasive jashtë bilancit". Mirëpo, në kartelën analitike nuk ekzistojnë përshkrime të qarta për të kuptuar përmbajtjen e kësaj shume, i vetmi përshkrim është rregullimi sipas barazimit.
- Vlera e kapitalit rezervë e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 269,668€, si pasojë e mospërputhjes mes shënimeve kontabël dhe pasqyrave financiare.

- Tek detyrimet afatgjata kishte prezantuar llogari tjera të pagueshme në vlerë prej 227,196€. Mirëpo, kjo shumë e mjeteve gjatë vitit 2016 ishte inkasuar nga pala tjetër përmes procedurave përmbarimore. Gjithashtu, nuk kemi mundur të identifikojmë se gjatë regjistrimit të kësaj shume, cila saldo është debituar. Një regjistrim i tillë i njëanshëm, ka shkaktuar prezantim jo të drejtë të pasqyrave financiare.
- Llogarite e arkëtueshme të prezantuara në pasqyra financiare vjetore ishin nënvlerësuar për 124,314€, si pasojë e mospërputhjes mes shënimeve kontabël dhe PFV-ve. Gjithashtu, ndërmarrja nuk ka arritur të përcjell nëntë letër konfirmime në vlerë prej 278,869€, me arsyetimin se nuk kanë adresat e klientëve dhe se nuk kanë ndonjë dëshmi (fature, kontrate) që dëshmon se shumata e regjistruar si llogari e arkëtueshme i takon klientit, ndërsa në shënimet kontabël këta klientë ekzistojnë. Në letër konfirmimin të cilën e kemi pranuar nga një klient i Trainkos-it, shumata e borxhit është 67,839€, përderisa në shënimet kontabël të Ndërmarrjes është 44,047€, me një nënvlerësim prej 23,791€. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos harmonizimit të shënimeve kontabël me klientët.
- Vlera e stoqeve e prezantuar në PFV ishte nënvlerësuar për 40,944€ në krahasim me shënimet kontabël. Gjatë numërimit fizik të stoqeve nga komisioni për regjistrimin fizik, vlera e stoqeve ishte për 73,550€ më e madhe se vlera në shënimet kontabël. Kjo diferencë nuk ishte evidentuar në regjistra kontabël, me ç'rast sjell deri tek nënvlerësimi i stoqeve.
- Shënimet shpjeguese nuk japin informacione shpjeguese të plota dhe të sakta, për të gjitha zërat e prezantuara në pasqyrat financiare, për më detaje shih nënkapitullin 3.7.
- Mos rivlerësimi i pasurive jo-qarkulluese. Sipas SNK 36 së paku një herë në 3 deri 5 vite duhet të bëhet rivlerësimi i pasurive. Trainkos që nga themelimi nuk kishte bërë rivlerësimin e pasurive. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos njohurive të standardit përkatës.
- Në regjistrat e pasurive jo qarkulluese nuk ishin regjistruar pasuritë (kompjuter, lloptop, mobilje etj) të cilat plotësojnë kriteret për njohje sipas SNK 16. Vlera e këtyre pasurive nuk mund të matet. Kjo ndikon në prezantim jo të saktë të vlerës së pasurive jo qarkulluese.
- Përveç gabimeve të prezantuara më lartë, kemi identifikuar edhe gabime tjera jo materiale në regjistrimin dhe prezantimin në PFV të llogarive të pagueshme, ekuitetit, dhe pasurive jo qarkulluese të cilat në detaje janë prezantuar në kapitujt përkatës në këtë raport.

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të Organizatave Buxhetore dhe NP në Kosovë, ZKA është i pavarur nga Trainkos dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kundërt.

Çështje Të tjera

Pasqyrat financiare vjetore të Trainkos për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2015 janë audituar nga një auditor tjetër, i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar të këtyre pasqyrave financiare me 29 prill 2016, për shkak të: hapjes së llogarive për asetet fikse nuk ishin trajtuar më dokumentacionin bazë, nga se ishin të përbashkëta "Trainkos" dhe "Infrakos"; ndërmarrja nuk ishte audiuar nga autoritetet tatimore për çështjet fiskale për vitin 2015; vlera se inventarëve-stoqeve në pasqyrën e pozicionit financiar kishte një diferencë prej 11,902€ me raportin e komisionit për regjistrimin e stoqeve; saldot e të arkëtueshmeve respektivisht të pagueshmeve nuk përkraheshin me konfirmimet nga blerësit respektivisht furnitorët; dhe ndërmarrja aktivitetin e saj ekonomik e ushtron me humbje financiare që e mbulon me subvencionime dhe përkrahje nga qeveria e Kosovës.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave përgjegjës për qeverisje dhe PFV-të

Kryesuesi i Bordit të Trainkos është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të PFV sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK), Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe Ligjet e Kosovës. Pasqyrat financiare janë të përgatitura në bazë të parimit akruar të kontabilitetit. Si dhe është përgjegjës për kontrole të brendshme të tilla të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa keq deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshin zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe ligjin nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime).

Kryesuesi i Bordit është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të NP.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Objektivat tona janë që të marrim siguri të arsyeshme nëse pasqyrat vjetore financiare në tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim që kryhet në pajtim me SNISA-t do të zbulojë një keq-deklarim material kur ekziston. Keq-deklarimet mund të rrjedhin nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të

auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

NP kërkohet të veproj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Kërkesat e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr. 02/L-123 për Shoqëritë Tregtare;
- Kërkesat e Ligjit nr. 04/L-087 për Ndërmarrjet Publike (me plotësime dhe ndryshime);
- Kërkesat e Ligjit nr.04/L-014 për Kontabilitet, Raportim Financiare dhe Auditim;
- Kërkesat e Ligjit të Prokurimit Publik (me ndryshime dhe plotësime);
- Kërkesat e Udhëzimit nr. 2/2013/MF për Strukturën dhe Përmbajtjen e Raporteve Financiare Vjetore;
- Nga NP-të, po ashtu kërkohet të përgatisë raportet si në vijim:
 - Statuti i NP-së;
 - Plani i Biznesit;
 - Raporte tremujore;
 - Raporte vjetore;
 - Raportin nga matja e kënaqshmërisë së Konsumatorëve; dhe
 - Draft plani dhe plani përfundimtar i prokurimit me kohë.

Çështja 1 - Përpilimi i Pasqyrave Financiare Vjetore – Prioritet i lartë

Në Memon tonë të auditimit të ndërmjetëm, të datës 14/12/2016, ne kemi ngritur disa çështje lidhje me pasqyrat financiare të cilat mund të kenë ndikim edhe në opinion. Çështjet e ngritura nuk ishin adresuar. Si pasojë, në draft pasqyrat financiare të datë 15/02/2017 ishin të nevojshme disa korrigjime financiare në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe shënimet shpjeguese që ishin përcjellë me gabime materiale.

Përkundër sugjerimeve tona, ne kemi identifikuar të gjeturat të cilat i kemi prezantuar tek baza për opinion.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, pasqyrat financiare vjetore të përgatitura nga Kryeshefi Ekzekutiv dhe Zyrtari Kryesor Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Bordin e Drejtorëve, nuk mund të konsiderohen të sakta për shkak se janë identifikuar gabime materiale.

1.4 Rekomandimet për pjesën e parë të raportit

Rekomandimi 1 **Prioritet i lartë** - Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet të cilat kanë ndikuar tek dhënia e Opinionit të Kundërt. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për të hequr gabimet në pasqyrat financiare vjetore dhe për ta siguruar një pamje të drejte dhe të vërtetë të tyre.

Rekomandimi 2 **Prioritet i lartë** - Kryesuesi i Bordit gjithashtu duhet të siguroj se janë vendosur procese efektive për të konfirmuar që plani i hartimit të PFV 2017 i adreson të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me pajtueshmërinë. Kjo duhet të përfshijë rishikimin e draft PFV-ve nga menaxhmenti, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime në vitet e mëparshme. PFV-të duhet të aprovohen nëse ndaj draft të tyre janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

2 Qeverisja

2.1 Hyrje

Aranzhimet efektive të qeverisjes janë thelbësore për Trainkos që të menaxhojë në mënyrë të suksesshme sfidat me të cilat përballet dhe të sigurojë ofrimin e shërbimeve më të mira në dobi të taksapaguesve dhe të shfrytëzuesve tjerë të shërbimeve.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se menaxhmenti është duke u munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe kontrollet.

Pjesa tjetër e rishikimit të aranzhimeve të qeverisjes pasqyron një shqyrtim të:

- fushave të aranzhimeve të qeverisjes ku nevojiten përmirësime të rëndësishme dhe ku besojmë se rekomandimet tona mund të gjenerojnë përmirësime pozitive, duke e përfshirë edhe shqyrtimin e sistemit të Auditimit të Brendshëm. Ndarjes së detyrave, përmbushjen e kërkesave (kënaqëshmërisë) të konsumatorëve; dhe
- fushave të menaxhimit financiar dhe kontrollit të identifikuar përmes punës sonë të auditimit, duke përfshirë punën specifike të drejtuar në çështjet e pajtueshmërisë në sistemet kyçe të të hyrave dhe shpenzimeve (këto fusha janë shqyrtuar në kapitullin 3 të këtij Raporti).

2.2 Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

Ekzistojnë zbrazëtira në aranzhimet ekzistuese të qeverisjes në Trainkos siç janë: mos zbatimi i rekomandimeve të vitit të kaluar, mos përcaktimi i afateve kohore lidhur me synimet afariste dhe financiare në planin e biznesit, sistemi i auditimit të brendshëm nuk është plotësisht efektiv në forcimin e kontrolleve të brendshme. Këto fusha duhet të rishikohen si dhe të ndërmerren veprime konkrete për adresimin e tyre.

Zbatimi i rekomandimeve të auditimit të jashtëm të vitit të kaluar si mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive nuk është marrë në konsideratë nga menaxhmenti i Trainkos. Ky është një tregues që Trainkos nuk është munduar t'i zhvilloj proceset ekzistuese dhe t'i forcoj kontrollet në shumë fusha.

Trainkos kishte të miratuar planin e biznesit për vitin 2016, por ky nuk përmban afatet kohore për realizimin e synimeve afariste dhe financiare. Mungesa e afateve kohore për realizimin e synimeve afariste dhe financiare, bën të pamundur që të përcjellët përmbushja e tyre në pikëpamje të afatit kohor, kur këto synime duhej të realizoheshin.

Më tej, sistemi i auditimit të brendshëm si hallk kyç e sistemit të kontrollit të brendshëm nuk ka arritur të mbështesë menaxhmentin lidhur me vlerësimin e kontrolleve të brendshme në ndërmarrje. Mos identifikimi i gabimeve financiare në auditimin e raporteve financiare të vitit 2015, ka rezultuar që këto gabime të barten edhe në pasqyrat financiare të vitit 2016. Megjithatë

edhe atëherë kur janë dhënë rekomandime nga auditimi i brendshëm, nuk është ndërmarrë asnjë veprim nga menaxhmenti për adresimin e këtyre çështjeve.

2.3 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Raporti i auditimit të jashtëm² për PFV-të të vitit 2015 të Trainkos-it ka rezultuar në gjashtë (6) rekomandime kryesore. Trainkos kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do të zbatohen të gjitha rekomandimet. Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, vetëm një (1) rekomandim ishte zbatuar. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën III.

Çështja 3 – Zbatimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- E gjetura** Nga gjithsej gjashtë (6) rekomandime të vitit paraprak, vetëm një (1) ishte zbatuar plotësisht. Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti i Trainkos-it nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit apo mos zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm.
- E gjetura** Mos zbatimi i rekomandimeve rritë rrezikun e pranisë së vazhdueshme të mangësive të njëjta të cilat ndërliken me pasqyrat financiare si dhe menaxhimin financiar dhe kontrollit në përgjithësi.
- Rekomandimi 3** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë zbatimin e planit të veprimit, i cili i përcakton afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Jashtëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. Arsyet për mos adresimin e rekomandimeve të vitit paraprak duhet të shqyrtohen me drejtorët relevant dhe të raportohen tek Kryeshefi Ekzekutiv.

2.4 Rishikimet specifike të qeverisjes

Puna jonë në fusha të veçanta të aranzhimeve të qeverisjes është bazuar përmes planifikimit të auditimit, duke marrë parasysh kontekstin brenda të cilit Trainkos operon dhe sfidat me të cilat përballet.

2.4.1 Përcaktimi i objektivave strategjike

Korniza ligjore, kërkon që Ndërmarrja Publike të hartoj Planin e Biznesit, plan i cili duhet të miratohet nga Bordi i Drejtorëve brenda afatit kohor ligjor.

² Raporti i auditimit të jashtëm - Auditimin e PFV të Trainkos për vitin 2015 e kishte bërë një kompani private audituese e jo nga ZKA, dhe raportimi i tyre ka përfshirë një raport me opinionin dhe një letër për menaxhmentin ku janë prezantuar të gjeturat me rekomandime.

Çështja 4 – Mos përcaktimi i afateve kohore për realizimin e synimeve afariste dhe financiare – Prioriteti i lartë

E gjetura	Bordi, ka hartuar dhe miratuar planin e biznesit për vitin 2016 brenda afatit kohor ligjor. Plani përmban synimet afariste dhe financiare të cilat ndërmarrja synon ti arrij gjatë vitit 2016 si dhe qasjen për realizimin e këtyre synimeve. Mirëpo, plani nuk përmban afatet kohore për realizimin e këtyre synimeve.
Rreziku	Mungesa e afateve kohore për realizimin e synimeve, bën të pamundur që të përcjellët përmbushja e tyre në pikëpamje të afatit kohor, kur këto synime duhet të realizohen.
Rekomandimi 4	Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që plani i biznesit, krahas synimeve afariste dhe qasjes për realizimin e tyre të përmbajë edhe afatet kohore për realizimin e tyre.

2.4.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Çështja 5 – Dobësi në kontrollet menaxheriale – Prioriteti i lartë

E gjetura	Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar të Trainkos ka nxjerrë në pah se linjat e llogaridhënies dhe komunikimit ishin funksionale përmes takimeve të rregullta dhe raportimit me shkrim. Mirëpo, pavarësisht kësaj, në shumë fusha kontrollet e brendshme nuk janë aplikuar në mënyre efektive dhe nuk kanë arritur t'i parandalojnë gabimet gjatë vitit. Me theks të veçantë, kontrollet ishin jo efektive për zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i vitit paraprak, menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme, pasurive jo qarkulluese, stoqet, realizimin e të hyrave, realizimin e shpenzimeve, menaxhimin e burimeve njerëzore, ekzekutimin e pagesave pa certifikim, kategorizim jo të duhur të shpenzimeve dhe vonesa në ekzekutimin e pagesave.
Rreziku	Mos aplikimi i kontrolleve në mënyre efektive ka reduktuar efektivitetin e menaxhimit financiar brenda Trainkos-it. Kjo gjithashtu mund të rezultojë me të dhëna jo të sakta financiare.
Rekomandimi 5	Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë shkaqet e mos aplikimit të kontrolleve në mënyrë efektive në fushat e cekura më lartë dhe të sigurojë eliminimin e tyre në mënyrë që të përmirësojë këto dobësi.

2.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Zyra e Auditimit të Brendshëm (ZAB) operon me dy anëtarë të stafit - Drejtori i ZAB dhe një auditor. ZAB kishte përgatitur planin strategjik dhe vjetor. Me planin vjetor kishte paraparë shtatë (7) auditime dhe kishte realizuar shtatë (7), por prej tyre ishin realizuar pesë (5) ndërsa dy (2) prej tyre ishin zëvendësuar me dy (2) tjera sipas kërkesës së menaxhmentit. Për të kryer një auditim efektiv nevojitet një program gjithëpërfshirës të punës i cili reflekton rreziqet financiare dhe të tjera të Trainkos-it dhe ofron siguri të mjaftueshme mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm. Ndikimi i produkteve të Auditimit të Brendshëm duhet të gjykohet nga rëndësia që i jep menaxhmenti adresimit të rekomandimeve si dhe mbështetja në sfida nga një Komitet efektiv Auditimi. Komiteti i Auditimit i përbërë nga tre anëtarë kishte mbajtur takime të rregullta mujore në të cilat ishin diskutuar planet dhe rezultatet e auditimit të brendshëm si dhe raporti i auditimit të jashtëm.

Çështja 6 - Mangësitë në funksionimin e ZAB-it - Prioriteti i lartë

E gjetura	<p>Ekzistojnë dobësi në lidhje me operacionet aktuale të ZAB si në vijim:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Auditimi i brendshëm lidhur me raportet financiare të vitit 2015, nuk kishte identifikuar asnjë nga dobësitë të cilat janë identifikuar nga auditimi ynë në lidhje me saldot fillestare të pasqyrave financiare të vitit 2016; dhe • Menaxhmenti i Trainkos-it nuk kishte përgatitur plan për zbatimin e rekomandimeve të ZAB-it dhe si pasojë kishte ngecje në zbatimin e tyre.
Rreziku	<p>Raporti i auditimit të brendshëm i cili nuk pasqyron rreziqet ekzistuese të entitetit, ndikon në mos identifikimin dhe mos adresimin e dobësive në kontrolle duke rezultuar me pasqyra financiare jo të sakta, në jo efikasitet dhe humbje operative. Po ashtu, mos përgatitja e planit të veprimit konfirmon jo gatishmërinë e menaxhmentit për të përmirësuar proceset ekzistuese.</p>
Rekomandimi 6	<p>Për të arritur përfitimin maksimal nga aktiviteti i auditimit të brendshëm, Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë që Komiteti i Auditimit të rishikojë në mënyrë kritike planet e auditimit të brendshëm, realizimin e planit, rezultatet dhe cilësinë e raporteve të auditimit. Gjithashtu, duhet të rishikojë veprimet e ndërmarra nga menaxhmenti në lidhje me rekomandimet e auditimit të brendshëm.</p>

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

3.1 Hyrje

Puna jonë për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) jashtë fushave të qeverisjes të përmendura në kapitullin dy, pasqyron punën e detajuar të ndërmarrë për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në Trainkos. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, menaxhimin e burimeve njerëzore, pasuritë, detyrimet si dhe ekuitetin.

3.2 Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Kontrollet mbi menaxhimin e përgjithshëm të Trainkos-it kanë nevojë për përmirësime. Proceset ekzistuese të planifikimit të buxhetit nuk janë adekuate, ato nuk kanë marrë në konsiderate shkaqet të cilat mund të ndodhin gjatë vitit që rrezikojnë ndërmarrjen në mos arritjen e objektivave dhe pamundësinë e mbulimit të shpenzimeve. Gjatë vitit 2016, ndërmarrja ka operuar me humbje në vlerë prej 1,186,710€. Në këtë rezultat financiar, si dhe në veprimtarinë e ndërmarrjes në tërësi, ndikim të rëndësishëm kishte mos arkëtimi i të hyrave të planifikuara nga transporti i mallrave, mos mbulimi i tërësishëm i humbjeve nga transporti i udhëtarëve për linjat e aprovuara nga Ministria e Infrastrukturës për vitin 2016 si dhe gjendja e mjeteve lëvizëse të vjetruara.

Duke pasur parasysh këto gjendja e tanishme, pa një bazë reale për të gjetur një zgjidhje adekuate në kapërcimin e saj dhe në rritjen e aktiviteteve dërgon në një situatë ku vihet në rrezik vijimësia e ndërmarrjes.

Më tutje, edhe proceset e tjera si rekrutimi i punonjësve nuk ishte menaxhuar në pajtueshmëri me kërkesat ligjore. Angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës si dhe pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues, trajtimi jo i barabartë i kandidatëve gjatë intervistës si dhe mos njoftimi me shkrim i aplikantëve, e minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

Ekzekutimi i pagesave të shpenzimeve të pa certifikuara, aplikimi i dyfishtë i TVSH-së si dhe mos caktimi i menaxherëve të kontratave janë tregues që kontrollet e brendshme në procedimin e pagesave dhe menaxhimin e prokurimeve kanë nevojë për përmirësim. Po ashtu, edhe proceset ekzistuese në menaxhimin e pasurisë duhet të rishikohen me theks të veçantë, hartimi i rregullores për menaxhimin e pasurisë dhe mënyra e trajtimit të pasurive në regjistrat kontabël.

Këto dhe dobësitë e tjera të prezantuara në këtë raport duhet të merren në konsideratë nga Bordi i Drejtorëve për të përmirësuar menaxhimin financiar dhe kontrollin në Trainkos.

3.3 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për Trainkos, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike si dhe të hyrat e realizuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Kategoritë ekonomike të planifikuara dhe të realizuara në €

Nr.	Përshkrimi	Planifikimi fillestar 2016	Planifikimi i rishikuar 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
1	Të hyrat	5,108,272	4,557,889	3,151,291	5,096,606
2	Shpenzimet	5,090,395	4,489,517	4,338,002	4,996,780
3	Fitimi/Humbja (1-2)	17,877	68,327	(1,186,711)	99,826

Të hyrat e prezantuar me sipër, përfshijnë të hyrat nga aktiviteti i ndërmarrjes, të hyrat nga subvencionet e pranuar nga Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe të hyrat nga grantet tjera.

Sa i përket shpenzimeve, vlera e prezantuar në tabelën me sipër prezanton të gjitha shpenzimet e realizuara gjatë vitit duke përfshirë edhe shpenzimet e zhvlerësimit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike - realizimi ndaj buxhetit në €

Përshkrimi	Buxheti Fillestar	Buxheti Final	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet sipas kategorive ekonomike:	5,090,395	4,489,517	4,338,000	5,969,073
Pagat dhe Mëditjet	1,723,706	1,807,500	1,769,155	1,773,449
Mallra dhe Shërbime	1,491,689	1,189,867	245,393	1,294,269
Kostoja e Shërbimit	1,875,000	1,492,150	1,338,142	1,929,064
Shpenzimet e Zhvlerësimit	0	0	985,310	972,291

Kategoria e Investimeve Kapitale nuk është prezantuar në tabelën me sipër, për arsye së investimet kapitale të cilat kanë përfunduar gjatë vitit, kosto e tyre njihet përmes shpenzimeve të zhvlerësimit. Shuma e investimeve të pranuar gjatë vitit është e prezantuar tek pasuritë si blerje gjatë vitit.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Rritja e buxhetit për Paga dhe Mëditje për 83,794€ është rezultat i rritjes së rekrutimeve të reja të cilat kanë ndodhur gjatë vitit 2016.
- Shpenzimi i buxhetit për kategorinë Mallra dhe Shërbime në raport me planifikimin ishte 20%. Ky realizim i ulët ka ndodhur si pasojë e gjendjes jo të mirë financiare.

-
- Në kuadër të kostos së shërbimit ishin planifikuar edhe shpenzimet komunale. Realizimi i buxhetit në raport me planifikimin për këtë kategori ishte 90%.

Çështja 7 - Kategorizim jo i duhur i shpenzimeve - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas SNK 2, Kostot e shërbimit konsistojnë kryesisht në kostot e punës dhe kostot e tjera të personelit të angazhuar drejtpërdrejtë në dhënien e shërbimit. Ndërsa kostot e tjera njihen si shpenzime në periudhën në të cilën ato shërbime kryhen. Në koston e shërbimit ishin përfshirë të gjitha shpenzimet komunale të cilat kanë të bëjnë me shpenzimet e energjisë elektrike, mbeturinave, ujit dhe ngrohjes në vlerë prej 44,022€, dh si të tilla është dashur të kategorizohen si shpenzime të periudhës.
- Rreziku** Përfshirja e kostove të komunalive në kostot e shërbimit krijon pasaktësi në zërat e pasqyrave financiare.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë që në kuadër të kostos së shërbimit të përfshihen vetëm ato shpenzime të cilat janë të lidhura me koston e shërbimit, ndërsa shpenzimet tjera të njihen si shpenzime të periudhës.

3.4 Të hyrat

Trainkos për vitin 2016 kishte planifikuar të realizoj të hyra në vlerë 4,577,889€, ndërsa kishte realizuar 3,151,291€. Trainkos realizon të hyra nga aktiviteti i saj si dhe nga burimet tjera të cilat janë prezantuar në tabelën në vijim.

Tabela 3. Të hyrat e planifikuara dhe realizuara në €:

	Buxheti fillestar 2016	Buxheti final 2016	Realizimi 2016	Realizimi 2015
Të hyrat:	4,016,272	4,577,889	3,151,291	4,351,131
Të hyrat nga transporti i mallrave	2,052,764	897,315	589,146 ³	1,734,612
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve	208,165	208,165	188,906	195,050
Të hyrat tjera	323,525	155,117	173,670	232,450
Të hyrat nga subvencionet - Ministria e Infrastrukturës	931,959	1,967,292	759,766	789,427
Të hyrat nga subvencionet - Ministria e Zhvillimit Ekonomik	500,000	500,000	499,999	500,000
Të hyrat nga grantet për investime kapitale ⁴			939,804	899,592

³ Shuma në transportin e mallrave përfshin shumën e realizimeve dhe të zbritjeve të marra në shumë 6,260€

⁴ Sipas SNK 20, grandet e marra për aktive të amortizueshme njihen si të ardhura gjatë periudhave në të cilat ngarkohet amortizimi për ato mjete. Kjo nënkupton që në shumën e realizuar për grande kapitale të paraqitur në PFV, të hyrat janë njohur duke u njohur si të ardhura pjesë -pjesë nga grandet e shtyra të viteve të kaluara për shumën sa është bërë amortizimi për ato investime kapitale.

Çështja 8 - Planifikimi i të hyrave - Prioritet i lartë

- E gjetura** Trainkos nga transporti i mallrave kishte realizuar vetëm 589,146€ të hyra, që në raport me buxhetin e rishikuar për këtë lloj të të hyrave janë realizuar vetëm 66%. Krahasuar me vitin e kaluar ndërmarrja është përballur me një ulje në realizimin e të hyrave për 66%. Kjo ka ndodhur për shkak të ndërprerjes së përkohshme të transportit nga ana e klientit kryesor. Megjithatë, kjo nuk ishte reflektuar në planin e rishikuar të hyrave si dhe të shpenzimeve për të siguruar menaxhimin e duhur të ndërmarrjes.
- Rreziku** Proceset e dobëta të planifikimit duke mos i marrë në konsiderate edhe shkaqet të cilat mund të ndodhin gjatë vitit rrezikon që kompania të mos arrij objektivat dhe të mos arrij t'i mbulojë shpenzimet duke rritur obligimet ndaj furnitorëve.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që realizimi i të hyrave monitorohet në mënyrë sistematike dhe ndryshimet apo devijimet nga planet fillestare reflektohen në planin e të hyrave.

3.4.1 Të Hyrat nga veprimtaria e NP

Të hyrat e realizuara nga veprimtaria e Trainkos-it në 2016 ishin në vlerë 951,722€. Ato kanë të bëjnë me të hyrat nga transporti i mallrave, nga transporti i udhëtarëve dhe nga shërbime tjera.

Çështja 9 - Mangësi në menaxhimin e të hyrave - Prioritet i mesëm

- E gjetura** Në bazë të kontratës për transportin e mallrave të lidhur mes Trainkos-it dhe Klientit, në rast të vonesës së pagesës të faturës, nga data e pranimit brenda një periudhe prej 20 ditësh pason ndëshkimi me interes prej 0.05% në vlerën e borxhit të përgjithshëm në ditë. Në tri raste nuk ishin aplikuar ndëshkime me rastin e vonesave të pagesës së faturës nga ana e klientit. Kjo për shkak se ndërmarrja nuk mbanë ndonjë regjistër për të identifikuar faturat e pa paguara dhe ato të paguara. Gjithashtu, për shkak se Trainkos nuk kishte bërë regjistrimin e të hyrave me kohë.
- Rreziku** Regjistrimi jo në kohë i faturave si dhe mos evidentimi i pagesës së secilës fature, shkakton vështirësi në identifikimin e faturave në të cilat duhet aplikuar ndëshkimet. Mos aplikimi i ndëshkimeve ndikon në ngadalësimin e arkëtimit të të hyrave dhe rritjen e llogarive të arkëtueshme.
- Rekomandimi 9** Kryesuesi i Bordit duhet të marrë masa në mënyrë që të sigurojë që regjistrimi i të hyrave behet me kohë, të mbajë një regjistër lidhur me faturat e paguara dhe ato të papaguara nga klientët dhe në rast të vonesave të pagesave nga klientët të aplikojë ndëshkimet.

3.4.2 Të hyrat nga burimet tjera

Të hyrat e realizuara nga subvencionet dhe grantet në vitin 2016 ishin 2,059,765€. Prej të cilave 759,766€ janë pranuar nga Ministria e Infrastrukturës për mbulimin e shpenzimeve të transportit të udhëtareve sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës dhe në pajtim me direktivat e BE-se sa i përket ofrimit të shërbimeve të interesit të përgjithshëm. Gjithashtu, 499,999€ janë të hyra të pranuar nga MZHE për mbulimin e pjesëshëm të humbjeve nga transporti i udhëtarëve. Gjatë kësaj periudhe, Trainkos kishte pranuar edhe 800,000€ për investime kapitale të ndara nga MZHE.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4.3 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes llogarisë bankare të Ndërmarrjes dhe kalkuloohen nga programi i kontabilitetit të Trainkos-it. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave të pagave sigurohen nga sistemi i kontrolleve të brendshme.

Numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 237 punonjës dhe 6 anëtarë të Bordit të Drejtorëve. Ne kemi testuar disa procedura të rekrutimit, dosjet e personelit si dhe kemi rishikuar listat e pagave dhe kemi krahasuar të dhënat nga shënimet kontabël dhe prezantimin e tyre në PFV.

Çështja 10 - Menaxhimi i burimeve njerëzore- Prioritet i lartë**E gjetura**

Gjatë testimit të kësaj kategorie kemi vërejtur mangësitë në vijim:

Sipas Ligjit të Punës (neni 8), Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon një marrëdhënie të punës. Gjatë vitit 2016, ndërmarrja kishte angazhuar 15 punonjës për punë dhe detyra specifike, mirëpo këta punonjës mbulonin pozitat e rregullta të punës dhe për të cilët nuk kishte zhvilluar procedura të rekrutimit.

Trajtim jo i barabartë i aplikantëve gjatë procesit të rekrutimit. Sipas Ligjit të Punës (neni 5) diskriminimi është i ndaluar në punësim dhe profesion, lidhur me rekrutimin në punësim. Gjatë procesit të rekrutimit për pozitën Agjent i Marketingut, kandidatët të cilët i janë nënshtruar intervistës nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë. Kjo për shkak se pyetjet e intervistës nuk ishin të aprovuara paraprakisht dhe të unifikuara për të gjithë kandidatët, mirëpo komisioni kishte aplikuar pyetje krejtësisht të ndryshme për secilin kandidatë.

Dobësi gjatë procesit të rekrutimit. Sipas Udhëzimit për Marrëdhënien e Punës (neni 5), kandidatët e përzgjedhur duhet të ftohen me shkrim së paku 48 orë para testimit. Në tri procese të rekrutimit aplikantët nuk ishin ftuar me shkrim për t'iu nënshtruar testit, me ç'rast disa nga aplikantët përkundër faktit që kanë plotësuar të gjitha kriteret për të marr pjesë në test, nuk kishin qenë pjesëmarrës në test. Sipas zyrtarit të burimeve njerëzore, të gjithë aplikantët ishin ftuar përmes telefonit.

Rreziku

Angazhimi i punonjësve për punë dhe detyra specifike për pozita të rregullta të punës si dhe pa zhvilluar ndonjë proces konkurrues, trajtimi jo i barabartë i kandidatëve gjatë intervistës si dhe mos njoftimi i aplikantëve me shkrim, e minimizon konkurrencën dhe rrit rrezikun e angazhimit të personave jo të duhur në pozitat e caktuara.

Rekomandimi 10

Kryesuesi i Bordit duhet të shqyrtojë mangësitë e identifikuar dhe të marrë masat e nevojshme që të respektohen dispozitat ligjore përkatëse me rastin e angazhimeve të stafit të ri, gjithashtu pozitat me përgjegjësi operationale duhet të ushtrohen nga zyrtarët/punonjësit me kontrata të rregullta të punës.

3.4.4 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime në vitin 2016 ishte 1,189,867€. Prej tyre ishin shpenzuar 245,393€. Ato kanë të bëjnë me shpenzime operative dhe shpenzime administrative të ndërmarrjes.

Çështja 11 - Mos certifikimi i shpenzimit nga zyrtari certifikues - Prioritet i lartë

E gjetura Sipas parimit akrual⁵ të kontabilitetit, shpenzimet regjistrohen në momentin e ndodhjes dhe jo në momentin e pagesës. Me rastin e regjistrimit të shpenzimeve, duhet të certifikohen nga zyrtari certifikues. Ne kemi hasur 23 raste që zyrtari certifikues nuk kishte bërë certifikimin e lëndëve. Kjo për shkak të mungesës së kontrollit nga ana e tij.

Rreziku Ekzekutimi i pagesave të shpenzimeve të pa certifikuara rritë rrezikun që të bëhen pagesa jo në përputhje me dëshmitë përkatëse si dhe shumat e tyre të mos jenë të sakta.

Rekomandimi 11 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë rritjen e kontrolleve në mënyrë që të gjitha shpenzimet të verifikohen dhe aprovohen nga Zyrtari Certifikues, para regjistrimit në sistemin e kontabilitetit.

Çështja 12 - Çmimet e shërbimeve në kundërshtim me kushtet e kontratës - Prioritet i mesëm

E gjetura Në marrëveshjen lidhur midis Trainkos dhe Hekurudhave të Kosovës Infracos Sh.a. për shërbimet e internetit dhe radiolidhjeve, specifikohet se shuma fikse për shërbimet e paraqitura në marrëveshje nënkupton shumat duke përfshirë të gjitha obligimet tatimore të aplikueshme në vend.

Megjithatë, në faturat e pranuar për shërbimet e internetit dhe radiolidhjeve, në 21 raste TVSH-ja ishte përlllogaritur dy herë. Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së kontrollit nga zyrtari certifikues.

Rreziku Mos funksionimi i sistemit të kontrollit të brendshëm me rastin e regjistrimit të faturave rritë rrezikun që të kryhen pagesa me vlera më të mëdha se sa që parashihet me marrëveshje.

Rekomandimi 12 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që zyrtari certifikues të verifikoj shpenzimet sipas kontratës dhe për pjesën e paguar më tepër të kërkojë që të kthehen në buxhetin e ndërmarrjes.

⁵ Parimi akrual - Njohja e transaksioneve dhe ngjarjeve janë të raportuara kur ato të ndodhin e jo kur paraja e gatshme është pranuar ose paguar.

Çështja 13- Mos caktimi i Menaxherit të Kontratës sipas Ligjit të Prokurimit Publik - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas Ligjit për Prokurim Publik, Autoriteti Kontraktues duhet të caktoj menaxherin e kontratës, menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. Në një rast Trainkosi nuk ka caktuar menaxherin e kontratës, me ç'rast nuk është përpiluar as plani për menaxhimin e kontratës. Kjo ka ndodhur si pasoje e mungesës së vendimit nga Kryeshefi Ekzekutiv.
- E gjetura** Mos caktimi i menaxherit të kontratës, rrezikon që Operatori Ekonomik mos të përmbush obligimet e performancës sipas kushteve të kontratës, pagesat të mos bëhen sipas kushteve të kontratës dhe të mos ketë kontroll të cilësisë.
- Rekomandimi 13** Kryesuesi i Bordit duhet të siguroj masat e duhura për respektimin e rregullave të prokurimit publik dhe të ushtrojë mbikëqyrje të përshtatshme për menaxhim.

3.4.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 800,000€, këto janë mjete të cilat MZHE i kishte ndarë për investime kapitale. Prej tyre, në 2016 ishin realizuar 722,672€. Ato kanë të bëjnë me projektin Riparimi i Lokomotivës – Ri fabrikimi dhe projekte tjera kapitale në proces.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Pasuritë

3.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera e pasurive jo qarkulluese në fund të vitit 2016 është 5,908,644€. Mbajtja e regjistrit përmbledhës të pasurisë në Trainkos bëhet me program kompjuterik të kontabilitetit. Në regjistrin e pasurive janë evidentuar vetëm pasuritë jo qarkulluese në vlerë mbi 1,000€.

Auditimi ynë ka përfshirë pasuritë e blera gjatë vitit 2016, për të verifikuar nëse ato ishin regjistruar në regjistrin kontabël dhe në regjistrin e pasurisë.

Struktura dhe ndryshimet tek këto pasuri janë dhënë në tabelën me poshtë:

Tabela 4. Pasuritë sipas kategorive dhe shumave në €

Përshkrimi	Toka	Ndërtesa	Pajisjet dhe Makineritë	Totali
Kosto historike (Vlera blerëse)	229,680	1,218,659	8,278,096	9,726,435
Blerjet gjatë vitit		7,868	1,085,130 ⁶	1,092,998
Zhvlerësimi i akumuluar	-	(248,764)	(3,657,940)	(3,906,704)
Zhvlerësimi i vitit	-	(61,293)	(924,017)	(985,310)
Rivlerësimi i pasurive				
Vlera neto në libra me 31/12/2016 ⁷	229,680	916,470	4,781,269	5,927,419

⁶ Ky projekt është kontraktuar në vitin 2015, ndërsa ka përfunduar dhe është njohur si pasuri në vitin 2016. Pagesat për këtë Pasuri ishin realizuar si në vijim: në vitin 2015 ishin pagua avancë 752,948€, ndërsa në vitin 2016 janë paguar 256,660€ dhe borxhi i mbetur është 75,552€.

⁷ Këto shuma janë sipas shënimeve të kontabilitetit, ndërsa në PFV janë të nënvlerësuara për shumën 10,132€ për pajisjet dhe makineritë, dhe ndërtesat për 8,642€

Çështja 14 - Menaxhim jo i mirë i pasurive jo qarkulluese - Prioritet i lartë

E gjetura

Gjatë testimit të pasurive jo qarkulluese kemi vërejtur mangësitë në vijim:

- Mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe PFV. Vlera e pasurive jo qarkulluese e prezantuar në PFV ishte 5,908,644€ ndërsa në shënimet kontabël kjo shumë ishte 5,927,419€, duke rezultuar me nënvlerësim të këtyre pasurive në vlerë prej 18,774€.
- Mungesa e rregullores për menaxhim të pasurive jo-qarkulluese. Sipas Statutit të kompanisë (neni 7), Shoqëria duhet të nxjerrë rregulloret, të cilat përmbajnë dispozita për administrimin dhe funksionimin e kompanisë aksionare. Trainkosi nuk kishte ndonjë rregullore për menaxhimin e pasurisë e cila duhet të përshtatet me nevojat dhe kërkesat e kompanisë duke u mbështet në standardet dhe rregullat në fuqi. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos vlerësimit të rëndësisë së rregullores për menaxhimin e pasurive.
- Prezantim jo i drejtë i vlerës se objektit. Kostot e hartimit të projektit për renovim të objektit në vlerë prej 7,868€ ishin kapitalizuar si rivlerësim i pasurisë edhe pse ky renovim nuk ishte realizuar. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos njohurive të SNK-ve nga ana e zyrtarit financiar dhe mungesa e zyrtarit të pasurisë në kohën e regjistrimit.

Rreziku

Nënvlerësimi i pasurive, mungesa e rregullores për menaxhimin e pasurisë, dhe rritja e vlerës se pasurisë në kundërshtim me SNK-te rrezikon që pasuritë të mos trajtohen në mënyrën e duhur dhe rrjedhimisht këto ndikojnë në prezantimin jo të saktë të pasurive në PFV.

Rekomandimi 14 Kryesuesi i Bordit duhet të nxjerr një rregullore të brendshme që përcakton procedurat standarde për menaxhim të pasurive jo qarkulluese dhe të sigurojë që pasuritë të trajtohen sipas SNK-ve dhe rregullave në fuqi, duke prezantuar vlerën e saktë të tyre në PFV.

3.5.2 Trajtimi i parasë së gatshme

Paratë dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë bilancet e parave të gatshme në llogaritë bankare dhe arkë. Në fillim të periudhës raportuese gjendja e parasë së gatshme ka qenë 1,826,035€, ndërsa në fund të periudhës kjo gjendje ishte 51,046€.

Çështja 15 - Shpenzimet për udhëtime zyrtare në kundërshtim me rregulloren - Prioritet i mesëm

E gjetura Sipas Rregullores për Udhëtime Zyrtare (neni 4), të gjithë punëtorët janë të obliguar që të bëjnë kërkesë për udhëtim zyrtar të bashkangjitur, së bashku me ftesën zyrtare ndaj institucionit dhe agjendën e takimit zyrtar. Në tri raste në vlerë prej 5,783€, kërkesat për udhëtime zyrtare nuk ishin mbështetur me dëshmi përkatëse, si agjenda ose ftesa zyrtare.

Rreziku Shpenzimi i mjeteve për udhëtime zyrtare pa dëshmi përkatëse, rrezikon që këto mjete të mos jenë shfrytëzuar për qëllime zyrtare, duke krijuar shpenzime të parasë, pa bazë ligjore.

Rekomandimi 15 Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se kërkesat për financimin e udhëtimeve zyrtare vlerësohen sipas rregulloreve në fuqi dhe të financohen vetëm kur plotësohen kriteret e duhura.

3.5.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme të Trainkos-it prezantojnë shuma të mjeteve që klientët i detyrohen ndërmarrjes për shërbimet që i kanë përfituar nga ndërmarrja. Trainkos ka prezantuar të arkëtueshmet në vlerë 1,807,575€, prej të cilave 107,975€ janë pjesë e subvencioneve nga Ministria e Infrastrukturës⁸. Të arkëtueshmet këtë vit tregojnë një trend në rritje në krahasim me vitin e kaluar për 406,935€. Kjo, për shkak të politikave jo-efektive të zbatuara nga menaxhmenti dhe mungesës së një strategjie për inkasimin e këtyre borxheve. Mangësitë lidhur me menaxhimin dhe prezantimin e llogarive të arkëtueshme janë prezantuar tek nënkëpitulli i Opinionit të auditimit.

3.6 Kapitali dhe Detyrimet

3.6.1 Kapitali

Në Pasqyrat Financiare Vjetore, kapitali është prezantuar sipas kësaj strukture:

Përshkrimi	Me 31/12/2016	Me 31/12/2015
Kapitali themeltar	25,000€	25,000€
Kapitali rezerve	4,733,550€	5,258,292€
Fitimet/Humbjet e bartura	560,051€	461,225€
Fitimet/Humbja e vitit aktual	(1,186,710)€	99,826.80€
Rezerva e rivlerësimit	-	-

⁸ Gjatë periudhës së auditimit, Ministria e Infrastrukturës këto mjete i kishte transferuar në llogarinë bankare të Trainkos.

Shënimet e prezantuara në këtë tabelë janë sipas shumave të paraqitura në PFV të cilat nuk janë të njëjta me shënimet në regjistrat kontabël.

Çështja 16 - Mos prezantim i saktë i ekuitetit - Prioritet i lartë

E gjetura

Gjatë testimit të ekuitetit kemi vërejtur mangësitë si në vijim:

- Kapitali rezervë përbëhet nga vlera e aseteve të investuara nga aksionari i ndërmarrjes. Vlera fillestare e kapitalit rezervë në datën e themelimit të kompanisë në vitin 2011 ishte 4,978,578€. Ndërsa, në fund të vitit 2016 në shënimet kontabël saldo e kësaj llogarie është 5,003,218€. Kjo rritje prej 15,640€ ka ndodhur si pasojë e regjistrimit të diferencave të stoqeve të cilat kanë rezultuar gjatë regjistrimit në fund të vitit nga komisioni për regjistrimin e stoqeve; dhe
- Vlera e fitimeve/ humbjeve të bartura e cila duhet të ishte prezantuar në PFV të vitit 2016 ishte 561,051€, mirëpo kjo shumë ishte nënvlerësuar në vlerë prej 1,000€. Kjo ka ndodhur si pasojë e mos kalkulimit të saktë nga zyrtari financiar.

Rreziku

Regjistrimi i stoqeve në kategorinë e rezervës së kapitalit si dhe nënvlerësimi i fitimeve/humbjeve të bartura, rrezikon që kompania të bëjë mbivlerësimin/ nënvlerësimin e ndonjë saldo tjetër me qëllim të balancimit të anës kreditore me anën debitore.

Rekomandimi 16

Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë që të bëhen korrigjimet e nevojshme duke vendosur një mekanizëm rishikues për të konfirmuar saktësinë e shumave të regjistruara në kontabilitet dhe të njëjtat të prezantohen në PFV.

Çështja 17 - Operimi i ndërmarrjes me humbje - Prioritet i lartë

- E gjetura** Gjatë periudhës raportuese ndërmarrja ka operuar me humbje në vlerë prej 1,186,710€. Në këtë rezultat financiar, si dhe në veprimtarinë e ndërmarrjes në tërësi, ndikim të rëndësishëm kishin disa arsye, e që më të rëndësishmet janë: transporti i mallrave si aktiviteti më i rëndësishëm i kompanisë këtë vit kishte rënie të vazhdueshme, mos mbulimi i tërësishëm i humbjeve nga transporti i udhëtarëve për linjat e aprovuara nga Ministria e Infrastrukturës për vitin 2016, dhe gjendja e mjeteve lëvizëse të vjetruara.
- Rreziku** Duke pasur parasysh trajtimet e më sipërme, gjendja e tanishme, pa një bazë reale për të gjetur një zgjidhje adekuate në kapërcimin e saj dhe në rritjen e aktiviteteve dërgon në një situatë ku vihet në rrezik vijimësia e ndërmarrjes.
- Rekomandimi 17** Kryesuesi i Bordit dhe Kryeshefi Ekzekutiv, duhet të hartojnë një plan strategjik të qëndrueshmërisë dhe të përmirësimit të biznesit i cili duhet të jetë i detyrueshëm në praktikë.

3.6.2 Trajtimi i detyrimeve

Pasqyra e detyrimeve në fund të vitit 2016 ishte 5,055,698€. Prej të cilave detyrime afatgjata janë 4,196,300€, të cilat paraqesin të hyrat e shtyra nga grandet dhe gjithashtu 227,196€ janë provizione ndaj palëve të lidhura. Ndërsa detyrime afat shkurta janë 859,398€, të cilat janë obligime ndaj furnitorëve dhe Administratës Tatimore të Kosovë.

Çështja 18 - Evidenca jo të sakta të llogarive të pagueshme - Prioritet i lartë**E gjetura**

Gjatë testimit të llogarive të pagueshme kemi vërejtur mangësitë në vijim:

- Mospërputhje në mes shënimeve kontabël dhe letër konfirmimeve nga furnitorët. Në dy letër konfirmime të pranuar nga furnitorët janë vërejtur mospërputhje me shënimet kontabël. Në një rast shuma e borxhit e konfirmuar nga furnitori është 0€, ndërsa në shënimet kontabël vlera e borxhit ndaj këtij furnitori është 3,171€. Ndërsa në rastin tjetër furnitori ka konfirmuar vlerën 4,534€, ndërsa në shënimet kontabël kjo vlerë është 5,030€. Kjo ka ndodhur si pasoje e regjistrimeve jo të sakta dhe mos harmonizimeve me furnitorët; dhe
- Llogari të pagueshme me vlera negative. Në shënimet kontabël figurojnë 10 furnitorë borxhi i të cilëve është i regjistruar me vlera negative, në total prej 19,660€ Kjo ka ndodhur si pasoje e regjistrimeve jo të sakta.

Rreziku

Mbivlerësimi i detyrimeve rrezikon që kompania të paguaj obligime furnitorëve për të cilat nuk u detyrohet. Ndërsa regjistrimi i detyrimeve me vlera negative e zvogëlon saldon e llogarive të pagueshme duke rezultuar me një vlerë të pa sakte në PFV.

Rekomandimi 18

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të siguroj që të bëhet harmonizimi i shënimeve kontabël me furnitorët, ndërsa vlerat negative të trajtohen dhe regjistrohen në regjistra kontabël adekuat.

3.7 Shënimet shpjeguese

Shënimet shpjeguese, paraqesin informacion lidhur me bazën e përgatitjes së pasqyrave financiare dhe politikave kontabël, japin informacion shpjegues të kërkuar nga SNRF-të dhe japin informacione shtesë të cilat nuk janë paraqitur në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e rrjedhës së parasë ose pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet, por janë të rëndësishme për t'i kuptuar cilëndo prej tyre.

Çështja 19 - Prezantim jo i plotë i shënimeve shpjeguese- Prioritet i lartë**E gjetura**

Sipas SNK 1, shënimet shpjeguese duhet të paraqiten në mënyrë sistematike, për sa kohë që kjo është e mundur. Çdo zë në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet ose pasqyrën e rrjedhës së parasë, duhet të referohet me informacionin përkatës në shënimet shpjeguese.

Gjatë analizimit të shënimeve shpjeguese janë identifikuar dobësitë si në vijim:

- Nuk ishin prezantuar informacione shpjeguese lidhur me pasuritë jo qarkulluese, zhvlerësimin e tyre, rritjet ose zvogëlimet;
- Stoqet ishin shpalosur me po të njëjtat diferenca në mes të shënimeve kontabël dhe pasqyrës financiare;
- Informacione jo të detajuara lidhur me llogarite e arkëtueshme. Sikurse tek pasqyra e pozitës financiare edhe tek shënimet shpjeguese saldo e llogarive të arkëtueshme ishte prezantuar ndryshe nga shënimet kontabël;
- Nuk ishte prezantuar informacion shpjegues lidhur me avancet edhe pse vlera e tyre 921,394€;
- Nuk ishin prezantuar informacione shpjeguese lidhur me ekuitetin dhe detyrimet;
- Informacione jo të detajuara lidhur me të hyrat dhe koston e shërbimit; dhe
- Prezantim i njëjte i detyrimeve kontingjente sikurse vitin e kaluar edhe pse gjatë vitit ka pasur tërheqje të mjeteve nga përmbaruesi lidhur me rastet e humbura gjyqësore nga ndërmarrja. Gjithashtu nuk është prezantuar ndonjë informacion shpjegues i detajuar për të kuptuar gjasat e ndodhjes së këtyre detyrimeve.

Rreziku

Prezantimi jo i plotë dhe jo i saktë i shënimeve shpjeguese, rrezikon që PFV të mos japin një pamje të drejte dhe të vërtetë.

Rekomandimi 19

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve duhet të sigurojë se gjatë hartimit të PFV-ve të prezantohen në shënimet shpjeguese informacione të detajuara, të plota dhe të sakta për secilin zë të pasqyrave financiare.

Shtojca I: Qasja dhe metodologjia e auditimit

Përgjegjësitë e Auditorit dhe të atyre të ngarkuar me qeverisje janë dhënë në hollësi në Opinionin e përcaktuar në kapitullin 1.2 të këtij raporti.

Derisa rezultat kyç i punës sonë është opinionin e auditimit, ky raport pasqyron tërësinë e punës sonë me fokus të veçantë edhe në Çështjet e Qeverisjes përfshirë Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Kjo e fundit mbështetet në programin tonë të gjerë të auditimit të pajtueshmërisë të bazuar në rrezik.

Përmbledhja e përgjithshme ka për qëllim t'i nxjerrë në pah gjetjet kryesore të auditimit dhe veprimet kyçe për të cilat Kryesuesi i Bordit duhet të sigurojë se janë ndërmarrë për t'i adresuar dobësitë e identifikuar të menaxhimit/të kontrollit.

Raporti i detajuar ofron një përmbledhje të gjerë të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në përcaktimin e shkakut të të gjeturave të auditimit dhe në dhënien e rekomandimeve të përshtatshme për t'i adresuar ato. Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë – Çështjet të cilat nëse nuk adresohen mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë gjithashtu do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen me prioritet të ulët i janë raportuar/do t'i raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në atë masë sa që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Shtojca II: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet të japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca III: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1. Pasqyrat Financiare - Aktivat	Auditori ju rekomandon që kompania të krijojë evidencën e duhur dhe të plotë për secilin aset veç e veç duke përfshirë këtu edhe gjitha shpenzimet e ndodhura për riparimin apo mirëmbajtjen domethënëse në mënyre që në çdo kohë të kemi një pasqyrim të plotë dhe objektiv për secilin aset veç e veç	Është zbatuar.		
2. Pasqyra e pozicionit financiar - Aktiva	Auditori ju rekomandon që të bëni barazimet me të shpeshta me klientët e juaj dhe të harmonizoni shënimet në mënyre që vlerat të përputhen në tërësi. Minimalisht para mbylljes së pasqyrave financiare duhet të i harmonizoni shënimet tuaja me vlerat që rezultojnë në evidencat kontabël të klientëve tuaj			Nuk është zbatuar.
3. Pasqyra e pozicionit financiar - Pasiva- Kapitali Aksionar	Gjatë procesit të auditimit janë vërejtur zërat e kapitalit themeltar dhe ato të fitimeve të grumbulluara dhe të pa sistemuara nuk pasqyrohen si të ndara por grumbullohen në një konto të vetme me emërtimin “ Bilanci i çeljes “ me çast nuk shihet ecuria e rezultateve financiare të kompanisë në perspektiv. Kjo gjetje ishte vërejtur edhe në pasqyrat e vitit 2014 dhe rekomandimi i auditorit mbetet akoma në fuqi.			Nuk është zbatuar

4. Pasqyra e pozicionit financiar – Pasiva- Të pagueshmet tjera dhe tregtare	<p>Auditori ju rekomandon se pasi të përmbyllni pasqyrat financiare në fund të periudhës raportuese zërat e të arkëtueshmeve të tjera tregtare si dhe të pagueshmeve tjera dhe tregtare të trajtohen sipas raportit obligim apo kërkesë dhe jo sipas klasës apo grupit të kontove.</p> <p>(Sqarim shtesë)</p> <p>Nëse një blerës ka bërë parapagim të trajtohet si obligim ndaj blerësit e jo të thuhet me vlerën e blerësve tjerë ndaj të cilave kompania ka kërkesa, e njëjta vlen edhe për furnitorët</p>			Nuk është zbatuar
5. Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse	<p>Gjatë procesit të auditimit kemi hasë në mospajtimin e pohimeve nga burimet e ndryshme për sa ju perkat</p> <p>‘Të hyrave gjithëpërfshirëse të kompanisë’ nga se pohimet për të hyrat në bilancin vërtetues respektivisht në “Pasqyrave e të ardhurave gjithëpërfshirëse “nuk korrespondon në plotësi me të hyrat nga deklaratat tatimore të TVSh-së, po e njëjta dukuri është vërejtur edhe nga pohimet e shpenzimeve operative të pasqyruara në B.V, respektivisht në P.A.GJ.P. që nuk korrespondojnë në plotësi me shënimet e blerjeve e të cilat i përkasin shpenzimeve operative të kompanisë, dhe të cilat janë pasqyruar me deklaratat tatimore për TVSh-në. Kjo gjetje ishte vërejte edhe gjatë auditimit të pasqyrave financiare të vitit 2014 andaj rekomandimi i auditorit mbetet po i njëjti.</p>			Nuk është zbatuar
6. Blerja përmes aplikimit të procedurave minimale	<p>Autoriteti kontraktues duhet të shmang përdorimin e shpeshtë të procedurave minimale dhe të përdorë procedurat e hapura, me qëllim të trajtimit të barabartë, të nxitjes së konkurrencës dhe të arrihet cilësia sipas parimit vlere për para.</p>			Nuk është zbatuar